

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41. /2014, 53/ 16 dhe 83/18), duke vepruar sipas një njoftimi përqendrimi të parashtruar nga SONA BLV PRESIZHEN FORGINGS LIMITED, me seli në Sona Enklejv Vilixh, Begumpur Khatola, Sektori 35, Gurugram, Harjana 122004, Indi, DarkoTasovac, me vendbanim në Bulevardin Zorana Xhixhiça 205/13, Beograd, Serbi, Velko Mihajloviç, me vendbanim në Vojvode Bogdana 30/9, Beograd, Serbi dhe Veselin Brankoviç, me vendbanim në Bacvanska 21, Beograd, Serbi, përmes Jasmina Ilieva Jovanoviç, avokate nga Shoqata e Avokatëve Debarliev, Dameski dhe Qeleshoska nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 14.07.2023, solli

AKTVENDIM

Vërtetohet se përqendrimi me të cilin SONA BLV PRESIZHEN FORGINGS LIMITED, me seli në Sona Enklejv Vilixh, Begumpur Khatola, Sektori 35, Gurugram, Harjana 122004, Indi, DarkoTasovac, me vendbanim në Bulevardin Zorana Xhixhiça 205/13, Beograd, Serbi, Velko Mihajloviç, me vendbanim në Vojvode Bogdana 30/9, Beograd, Serbi dhe Veselin Brankoviç, me vendbanim në Bacvanska 21, Beograd, Serbia, do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi NOVELIC D.O.O. BEOGRAD-ZVEZDARA, me seli në rr. Velka Dugosheviça 54, Beograd, Republika e Serbisë, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës më 13.06.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: Komisioni), është dorëzuar njoftim për përqendrim nga SONA BLV PRESIZHEN FORGINGS LIMITED, me seli në Sona Enklejv Vilixh, Begumpur Khatola, Sektori 35, Gurugram, Harjana 122004, Indi, DarkoTasovac, me vendbanim në Bulevardin Zorana Xhixhiça 205/13, Beograd, Serbi, Velko Mihajloviç, me vendbanim në Vojvode Bogdana 30/9, Beograd, Serbi, ku SONA BLV PRESIZHEN FORGINGS LIMITED, DarkoTasovac, Serbi, Velko Mihajloviç, Serbi, Veselin Brankociq, Serbi, **do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi** NOVELIC D.O.O. BEOGRAD-ZVEZDARA, me seli në rr. Velka Dugosheviça 54, Beograd, Republika e Serbisë.

Pronarët aktualë të NOVELIC D.O.O. BEOGRAD-ZVEZDARA, Darko Tasovac, Serbi, Velko Mihajloviq, Serbi dhe Veselin Brankoviç, Serbi, do të mbajnë një pjesë totale prej 46% të kapitalit të NOVELIC D.O.O. BEOGRAD-ZVEZDARA. Transaksioni përfundimisht do të rezultojë në një kontroll të përbashkët ndërmjet SONA BLV PRESIZHEN FORGINGS LIMITED dhe Partnerëve të Minoritetit (Darko Tasovac, Serbi, Velko Mihajloviq, Serbi dhe Veselin Brankoviç, Serbi,)

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

SONA BLV PRESIZHEN FORGINGS LIMITED është një prodhues i sistemeve dhe komponentëve të automobilave dhe një ofrues i zgjidhjeve të teknologjisë së automobilave aktive në mbarë botën. SONA BLV PRESIZHEN FORGINGS LIMITED dhe grupi i saj korporativ i kompanive ("Grupi i Blerësit") kryejnë aktivitete të ndryshme në sektorin e automobilave siç janë dizajni, prodhimi, shitja dhe marketing të dhëmbëzoreve të fërkua me precizitet, nyje diferenciale, sistemeve të automobilave, motorëve, kontrollorëve dhe aplikacioneve të tjera.

Grupi i Blerësit është i pranishëm në Indi, Hong Kong, SHBA, Meksikë dhe Kinë.

As SONA BLV PRESIZHEN FORGINGS LIMITED, As ndonjë anëtar i grupit të tij korporativ nuk ka prezencë në Maqedoninë e Veriut, as nuk kryen shitje apo aktivitete të tjera në ndonjë treg maqedonas.

Partnerët e minoritetit zotërojnë gjithashtu pjesë të barabarta në kompaninë SQUARE COIN d.o.o. Beograd (SQUARE COIN d.o.o. Beograd) aktiviteti i biznesit dhe vëllimi i regjistruar i shërbimeve të biznesit janë në fushën e programimit kompjuterik.

SQUARE COIN d.o.o. nuk ka aktivitete biznesi në Maqedoninë e Veriut.

NOVELIC D.O.O. BEOGRAD-ZVEZDARA dhe grupi i saj operojnë në fushën e prodhimit të sensorëve të radarëve "mmWave" dhe zgjidhjeve të tjera shtesë në sektorin e radarëve, siç janë platformat e radarëve dhe zgjidhjet "ADAS" (Advanced Drive-Assistance Systems).

NOVELIC D.O.O. BEOGRAD-ZVEZDARA ka selinë në Serbi dhe është kompania mëmë e disa shoqërive të varura në JIE ("Grupi i Shoqërisë së Synuar "). Grupi i shoqërisë së synuar ofron operacionet dhe shërbimet e tij në Serbi, JIE si dhe në botë.

NOVELIC D.O.O. BEOGRAD-ZVEZDARA ka një shoqëri të varur të themeluar në Maqedoninë e Veriut - Shoqëria e programimit kompjuterik NOVELIC ESC SHPKNJP Shkup, me seli në Bul. Partizanski Odredi nr.63, Shkup.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски

